

 UNIVERSITETI I PRIZRENIT University of Prizren Universiteti Prizren "UKSHIN HOTI"	
Pranuar me dt.	26.09.2019
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
308	01-333



Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Universitetit të Tiranës dhe Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren

Kjo marrëveshje po lidhet midis Universitetit të Tiranës i ndodhur në Tiranë, Shqipëri dhe Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, i ndodhur në Prizren, Kosovë. Palët e mësipërme bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Universiteti i Tiranës dhe Universiteti i Prizrenit do të zhvillojnë bashkëpunimin akademik në fushën e arsimit, kërkimit dhe të fushave të tjera që janë në interes të të dyja palëve.

Neni 2

Bashkëpunimi do të realizohet mbi bazën e shkëmbimit reciprok të anëtarëve të fakulteteve, asistentëve dhe studentëve, dhe gjithashtu nëpërmjet shkëmbimit të informacionit arsimor dhe akademik.

Neni 3

Bashkëpunimet e mbështetura në këtë marrëveshje do të përcaktohen në detaje në protokole të veçanta paraprakisht nga të dy Universitetet duke përcaktuar detajet e marrëveshjeve në praktikë dhe më pas do të firmosen nga përfaqësuesit ligjor të secilës palë".

Neni 4

Palët mundën që në fushën e bashkëpunimit akademik:

- Të vendosin projekte kërkimore të përbashkëta dhe të kryejnë raportet e përbashkëta.
- Të përfshij punonjës akademik nga pala tjetër në aktivitetet kërkimore.
- Të organizojnë së bashku takime akademike rreth temave të përcaktuara më parë.
- Të shkëmbejnë informacione akademike.

Neni 5

Palët mundën në fushën e bashkëpunimit arsimor:

- Të organizojnë kurse të bërëbashkëta afat shkurtëra apo afat gjata dhe seri leksionesh mbi tema të përcaktuara më parë.
- Të shkëmbejnë eksperiencë rreth procesit të mësimdhënies dhe metodave në mënyrë që të përmirësohet efënca e studimit.
- Të shkëmbejnë studentë për kurse apo praktika etj.

Neni 6

Palët mund të organizojnë programe diplomimi për specialist dhe për diploma masteri, dhe gjithashtu borde vlerësimi të rëndësishme për përgatitjen dhe mbrojtjen e disertacionit të doktoraturës. Palët mund të shkëmbejnë anëtarë të fakulteteve për studimet e post- doktoraturës sipas parimit të reciprocitetit.

Neni 7

Kjo marrëveshje do të hyj në fuqi në datën e nënshkrimit së përfaqësueseve të secilit Universitet.

Marrëveshja është në fuqi për një periudhë 4 (katër) vjeçare. Mund të ripërtërihet automatikisht për 4 (katër) vite të tjera vetëm në çoftëse ndonjëra palë i përcjell palës tjetër një njoftim për përfundimin e kësaj marrëveshjeje, jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data e mbarimit të afatit.

Neni 8

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet dhe/ose amandamendohet me pranimin e të dyja palëve. Ndryshimet dhe/ose amandamendimet do të bëhen në formën e anekseve të Marrëveshjes dhe do të nënshkruhen nga personat e autorizuar të të dyja palëve.

Neni 9

Marrëveshja është nënshkruar në 2 (dy) kopje identike në gjuhën Shqipe. Të gjitha kopjet kanë të njëjtën forcë ligjore dhe janë njësoj të vlefshme për të dyja palët.

Datë: 26.09. 2019

PËR UNIVERSITETIN E TIRANËS

REKTORI

Prof. Dr. MYNYRE KONI



PËR UNIVERSITETIN E PRIZRENIT

REKTORI

Prof. Asoc. Dr. ISMET TEMAJ

